



KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01- 0005630-14/26, dt. 10.02.2026

Mitrovicë

02-060/01-0005630-14/26
10.02.2026

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, nenit 25, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenit 5, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-087 Për ndërmarrjet publike; nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, neni 46 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 10.02.2026, sjell këtë:

VENDIM

Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të KRM "Uniteti"

- Me këtë vendim FORMOHET Komisioni Komunal të Aksionarëve të KRM "Uniteti" në përbërje:
 1. Jeton Zeneli,
 2. Ferdi Kadriu, dhe
 3. Arijeta Beqiri Hyseni (E emëruar nga Kryetari i Komunës).
- Komisioni Komunal i Aksionarëve vepron në emër të Komunës dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin Për ndërmarrjet publike dhe Ligjin Për shoqëritë tregtare.
- Çdo Komision Komunal i Aksionarëve duhet, me shumicë të thjeshtë votash, të vendosë se si do t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar.
- Komisioni Komunal i Aksionarëve përfaqëson Komunën në mbledhjen e aksionarëve dhe ushtron të drejtën e votimit të komunës në përputhje me nenin 5.2 të Ligjit për ndërmarrjet publike.
- Komisioni do të përgatisë dhe nxjerrë një politikë të pronësisë e cila i paraqet objektivat e përgjithshme të Komunës në lidhje me pronësinë dhe rolin e saj në qeverisjen e KRM "Uniteti". Kjo politikë e pronësisë duhet të jenë të përputhje me dispozitat e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe dispozitat tjera të aplikueshme ligjore në Kosovë. Kjo politikë e pronësisë po ashtu duhet të përmbajë dispozita të hollësishme mbi mënyrën e zbatimit të saj.
- Për të arritur qëllimin e cekur në pikën 5 të këtij Vendimi, Komisioni i Aksionarëve do të bashkëpunojnë për përgatitjen e një politike të përbashkët të pronësisë me komisionet nga Komunal e Vushtrisë dhe Skenderajt, në rast se marrëveshje nuk mund të arrihet në lidhje me elementet përmbajtësore të politikës së përbashkët të pronësisë, çështja do të vendoset me shumicën e votave të Komisioneve përkatëse Komunale të Aksionarëve.
- Komisioni Komunal i Aksionarëve i përgjigjet Kuvendit të Komunës mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me ligj dhe do t'i raportojë Kuvendit të Komunës në bazë vjetore mbi performancën e këtyre kompetencave dhe përgjegjësi, si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë, si dhe do t'i sigurojë të dhëna kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit të Komunës mbi mënyrën e menaxhimit të ndërmarrjes.
- Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi Kuvendit

Safet KAMBERI

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit

1 x 1 MAPL-së

1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës

Anëtarëve të Komisionit